

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6372
E martë, 27 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Tri vjet pa veprimtarin Adem Demaçi



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA SIGURON MEDALJEN E DYTË TË ARTË NË 'TOKIO 2020',
PENSIONOHET NGA XHUDOJA 'MBRETËRESHA' MAJLINDË

KRENARIA E KOSOVËS

Nora Gjakova e ka fituar medaljen e dytë të artë për Kosovën në "Tokio 2020", kurse kjo është medalja e tretë në historinë e Lojërave Olimpikë për Kosovën, pasi një të tillë e kishte fituar Majlinda Kelmendi në "Rio 2016". Në ditën e këtij suksesi historik, "mbretëresha" e xhudos, Majlinda Kelmendi, vendosi t'i japë fund karrierës në xhudo




Rriten rastet me Covid, institucionet bëjnë thirrje për vaksinim

FAQE 3



KATËR TRAGJEDITË NGA AKSIDENTET ME AUTOBUSË ME BASHKATDHETARË

FAQE 4-5



AKTUALE



KRYEMINISTRI KURTI VIZITOI NË KROACI TË LËNDUARIT NGA AKSIDENTI TRAGJIK QË NDODHI TË DIELËN

F. 5

VAZHDON IMPLEMENTIMI I PLANIT OPERATIV "SIGURIA NË TRAFIK 2021"

F. 6

KURTI NDERON POLICIN ENVER ZYMBERI NË DHJETËVJETORIN E RËNIES NË KRYE TË DETYRËS

F. 7



EKONOMI

PUNËTORËT E ATK-SË HYJNË NË GREVË ME ORAR TË PLOTË

F. 8

RUKIQI: MUNGESA E FUQISË PUNËTORE, SHOQËTËSUESE

F. 8



SPORT

DUKAGJINI TRANSFERON ISH-FUTBOLLISTIN E SHQIPËRISË, AHMED JANUZI

F. 14

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kombinimi 'AstraZeneca' - 'Pfizer' rrit nivelin e antitropave, thotë studimi

SEUL, 26 KORRIK - Vaksinimi i përzier kundër koronavirusit, së pari me vaksinën "AstraZeneca", pastaj me "Pfizer/BioNTech", rrit nivelin e antitropave neutralizues për gjashtë herë krahasuar me dy doza të "AstraZeneca"-s, tregon një studim i Koresë së Jugut. Studimi përfshiu 499 punonjës mjekësorë: 100 prej tyre morën doza të përziera, 200 morën dy doza "Pfizer/BioNTech" dhe pjesa tjetër morën dy doza "AstraZeneca". Të gjitha vaksinimet rezultuan me antitropa neutralizues, që e

ndalojnë virusin nga hyrja në qeliza dhe nga shumimi i tij. Përziera e vaksinave tregoi sasi të ngjashme të antitropave që janë gjetur te personat që kanë marrë dy doza të vaksinës "Pfizer/BioNTech". Edhe një studim i publikuar muajin e kaluar në Mbretërinë e Bashkuar ka gjetur se një dozë e vaksinës "Pfizer/BioNTech", nëse jepet katër javë pas një doze të vaksinës "AstraZeneca", do të prodhojë përgjigje më të mirë imunitare. Studimi i Koresë së Jugut

gjithashtu analizoi aktivitetin neutralizues ndaj varianteve kryesore shqetësuese të koronavirusit, ka njoftuar Agjencia e Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve në Korenë e Jugut. Asnjë nga kombinimet nuk demonstroi aktivitet të zvogëluar neutralizues kundër variantit "Alfa", të identifikuar së pari në Britani, por neutralizimi u ul me 2.5 deri në 6 herë ndaj varianteve "Beta", "Gama" dhe "Delta", të zbuluara së pari në Afrikën e Jugut, përkatësisht në Brazil dhe Indi.



Mbi 150 njerëz pozitivë me koronavirus në Lojërat Olimpikë



TOKIO, 26 KORRIK - Organizatorët e Lojërave Olimpikë në Tokio thanë se 153 njerëz të akredituar për Olimpiadën kanë rezultuar pozitivë me koronavirus qysh në fillim të muajit - 16 prej tyre vetëm në 24 orët e fundit. Totali përfshin 19 atletë. Disa prej tyre janë banorë të Fshatit Olimpik, ku 16 njerëz

kanë dalë pozitivë. Ata janë larguar nga apartamentet dhe janë vendosur në hotele karantinë. E shtyrë për një vit për shkak të pandemisë së koronavirusit, Olimpiada ka nisur më 23 korrik. Qyteti nikoqir, Tokio, është në gjendje të jashtëzakonshme për shkak të rasteve me

koronavirus, ashtu si edhe tri prefektura fqinje. Edhe tifozët nga Japonia, edhe ata nga jashtë, janë ndaluar të marrin pjesë në ngjarjet olimpikë. Olimpiada do të përfundojë më 8 gusht. Disa ditë më pas, më 24 gusht, nisnin Lojërat Paraolimpikë.

Izraeli synon t'i zvogëlojë 85 për qind të emetimeve të karbonit

JERUSALEM, 26 KORRIK - Izraeli do t'i zvogëlojë emetimet e karbonit për 85 për qind nga nivelet e vitit 2015. Kryeministri Naftali Bennett ka thënë se vendimi do ta ndihmojë vendin që gradualisht të zhvendoset në një ekonomi me nivele të ulëta të karbonit. Synimet përfshijnë zvogëlimin e shumicës

dërmuese të emetimeve nga transporti, sektori i energjisë elektrike dhe mbetjet komunale. Bota tashmë është ngrohur për rreth 1.2 gradë celsius që nga fillimi i epokës industriale dhe temperaturat pritet të vazhdojnë të rriten nëse qeveritë nuk bëjnë zvogëlime të

mëdha të shkarkimeve të gazrave, që thuhet se i kontribuojnë ngrohjes globale. Bennett ka pohuar se plani i tij do të çojë në "ekonomi të pastër, efikase dhe konkurruese" dhe se do ta vendosë Izraelin në ballë të betejës kundër ndryshimeve klimatike.

Synimet e Izraelit janë në përputhje me Marrëveshjen e Parisit për Klimën, një traktat ndërkombëtar për luftimin e ngrohjes globale, ligjërisht i detyrueshëm, i miratuar nga gati 200 vende. Traktati synon ta mbajë ngrohjen globale nën 2 gradë celsius.



OKB: Numri i viktimave civile në Afganistan është në rritje

NYU-JORK, 26 KORRIK - Gati 2 400 civilë afganë u vranë ose u plagosën në maj dhe qershor - kjo është shifra më e lartë për këta dy muaj që nga fillimi i regjistrimeve në vitin 2009, thanë Kombet e Bashkuara. Në një raport të publikuar të hënën nga Misioni i Ndihmës i OKB-së në Afganistan thuhet se në periudhën janar-qershor të këtij viti janë dokumentuar 5 183 viktima civile - prej të

cilave 1 659 vdekje. Shifra paraqet rritje për 47 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Luftimet midis militantëve talibanë dhe forcave të qeverisë afgane janë shtuar në maj dhe qershor, pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka njoftuar se trupat amerikane do të tërhiqen nga Afganistani deri më 31 gusht.



Në Katar, javët e fundit, janë zhvilluar negociata për paqe midis militantëve dhe qeverisë

afgane, por përparim është bërë pak. Sipas raportit të OKB-së, gratë dhe fëmijët përbëjnë 46 për qind të të gjitha viktimave civile në gjysmën e parë të vitit. Në total, 468 fëmijë janë vrarë dhe 1 214 janë plagosur, ndërsa 219 gra janë vrarë dhe 508 janë plagosur, thuhet në raport. Raporti fajëson forcat

kundërqeveritare për 64 për qind të të gjitha viktimave civile; 39 për qind thuhet se janë shkakuar nga talibanët, gati 9 për qind nga grupi militant Shteti Islamik dhe 16 për qind janë të papërcaktuara. Raporti, po ashtu, thekson se trupat qeveritare dhe degët e tyre janë përgjegjëse për rreth 25 për qind të të gjitha viktimave civile.

NË 24 ORËT E FUNDIT 14 QYTETARË KANË REZULTUAR POZITIVË ME VIRUSIN COVID-19

Rriten rastet me Covid, institucionet bëjnë thirrje për vaksinim



Numri i infektiveve të reja me Covid-19 ka filluar të rritet ditët e fundit në Kosovë. Derisa më 17 korrik në total numri i rasteve aktive me Covid kishte rënë nën 100, tani numri i rasteve aktive është 169. Kjo ka nxitur institucionet shëndetësore dhe liderët institucionalë që t'u bëjnë thirrjeve qytetarëve që të vaksinohen, duke thënë se të gjitha vaksinat kundër Covidit që ka Kosova janë të sigurta

EPOKA
ERE

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 26 KORRIK - Në javën e fundit ka filluar të rritet numri i rasteve të reja të infektimit me Covid-19. Derisa në pjesën e parë të muajit korrik numri ditor i rasteve të infektimit ishte njëshifror, në pjesën e dytë të muajit rastet ditore janë dyfishuar. Më 17 korrik në total numri i rasteve aktive në Kosovë kishte rënë nën 100, kurse tani numri total i rasteve aktive është 169. Rritja e numrit të rasteve me Covid nuk ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve të vdekjes si pasojë e

koronavirusit.

Rasti i fundit i vdekjes nga Covid-19 është raportuar më 20 korrik.

Vetëm në 24 orët e fundit Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se janë regjistruar 14 raste të reja të infektimit me Covid-19 dhe gjashtë qytetarë janë shëruar. “Nga 2 406 testime, 14 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar gjashtë qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 597. Në total numri i rasteve aktive është 169”, është

thënë në njoftimin për media të Ministrisë së Shëndetësisë. Në kohën kur po rritet rreziku nga varianti ‘Delta’ i koronavirusit, institucionet shëndetësore dhe liderët politikë u kanë bërë thirrje qytetarëve të vaksinohen sa më shpejt me vaksinat kundër Covidit.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë me dije se e vetmja rrugë për të dalë nga pandemia është vaksinimi. Përmes një njoftimi për media, IKShPK-ja ka bërë me dije se me vaksinë qytetarët mbrojnë veten, familjen dhe të afërmit.

“Qytetarë të dashur, vaksinohuni! Me vaksinë mbroni veten, familjen, të afërmit, kombin dhe njerëzimin kundër Covid-19”, është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka ftuar qytetarët që të vaksinohen. Ai ka thënë se vaksinat që përdoren në Kosovë janë të sigurta. “Vaksinat i kemi të sigurta. Kosova është vendi i vetëm në rajon që po përdor vetëm vaksinat e aprovuara nga Agjencia Federale e Barnave e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Agjencia

Evropiane e Barnave, pra ‘Pfizer’ dhe ‘AstraZeneca’. Tani mund të vaksinohen të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeç dhe mund ta zgjedhin vaksinën që dëshirojnë ta marrin. Të dashur qytetarë, ju bëj thirrje që të caktoni termin për vaksinim”, ka shkruar kryeministri në profilin e vet në “Facebook”.

Ai ka treguar se pandemia është nën kontroll, por rreziku nga varianti “Delta” ekziston. “Pas përpjekjeve të përbashkëta, sot në Republikën tonë janë vetëm 126 raste aktive nga 12 808 sosh sa ishin në ditën e parë të punës sonë. Pra, pandemia është vënë nën kontroll dhe situata është përmirësuar dukshëm, por tani rrezikohemi nga përhapja e variantit ‘Delta’ të virusit. Përballë tij mburoja për secilin prej nesh është vakcina, kurse për të gjithë së bashku vaksinimi masiv”, ka vlerësuar Kurti.

Ndërkohë vaksinimi normal i qytetarëve ka vazhduar. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 393 doza të vaksinës. Sipas kësaj ministrie, prej fillimit të këtij procesi deri më tani janë dhënë 357 980 doza të vaksinës kundër Covidit. “Në 24 orët e fundit janë dhënë 393 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 357 980 doza të vaksinës. Deri më sot 109 233 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 2 406 testime, 14 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19”, është thënë në njoftimin për media të ministrisë.

Qeveria e Kosovës ka lehtësuar pothuajse të gjitha masat kundër Covidit. Së fundit, është bërë edhe zgjatja e orarit deri në orën 01:00 pas mesnate për gastronomi, derisa numri i të ftuarve në hapësirat e mbyllura është rritur në 300 persona.

25 kandidatë aplikojnë për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës ka bërë me dije se është mbyllur konkursi për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK). Për këtë pozitë kanë konkurruar 25 persona, në mesin e tyre edhe drejtori aktual i AKK-së, Shaip Havolli. “Bazuar në konkursin e shpallur me

datë: 07. 07. 2021 - 21. 07. 2021, për këtë pozitë kanë aplikuar 25 persona. Në regjistër janë përfshirë edhe aplikacionet që kanë arritur nëpërmjet postës”, ka njoftuar Kuvendi i Kosovës. Për këtë pozitë kanë aplikuar: Sali Rexhepi, Sadat Lekiqi, Lulzim Xhymshiti, Ilir Islami, Adil Bytyqi, Betim Elezaj, Sadri

Abazi, Halil Cenaj, Shaip Havolli, Avdi Muzliukaj, Muharrem Mustafa, Ekrem Demolli, Esad Ejupi, Afrim Atashi, Fahri Maxhuni, Visar Krasniqi, Burim Sadiku, Osman Neziri, Valbona Osmani, Blerim Kelmendi, Yll Buleshkaj, Lulzim Ismajlaj, Basri Kastrati, Artan Mezraja dhe Avdyl Jerliu.





Kryeministri Kurti vizitoi në Kroaci të lënduarit nga aksidenti tragjik që ndodhi të dielën

PRISHTINË, 26 KORRIK - Drejtuesi i autobusit të Kosovës, i cili dyshohet se ka shkaktuar aksidentin e rëndë në Sllavonski Brod të dielën, të hënën u mor në pyetje në Zyrën e Prokurorit të Shtetit. Atij i është caktuar një avokat, sipas detyrës zyrtare, dhe ai është mbrojtur në heshtje, u ka thënë gazetarëve zëvendësprokurori i Shtetit për qarkun në Sllavonski Brod, Franjo Kopunij. "Nuk e morëm mbrojtjen e tij. Do të merret një vendim mbi hetimin. Pas kësaj do të propozohet paraburgimi mbi të cilën do të vendoset nesër", tha ai.

Pasi është marrë në pyetje në Zyrën e Prokurorit, ai është kthyer në mbajtje. Ai do të dalë sërish para prokurorisë, të martën në orën 09:00, ku do të vendoset për paraburgim. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) ka njoftuar se 26 persona janë në proces të lirimit nga spitali, 15 të tjerë, që janë në gjendje stabile, do ta vazhdojnë trajtimin mjekësor në Sllavonski Brod, ndërsa një nga pacientët është në gjendje kritike. Drejtori i Spitalit të Përgjithshëm

të Sllavonski Brod, Josip Samarxhiq, tha se "dy pacientë me rrezik për jetën janë ende në njësitë e kujdesit intensiv dhe gjendja e tyre po përcillet nga afër dhe u nënshtrohet metodave të kujdesit intensiv". "Dje, në orët e paradites, shtatë operacione u kryen te të lënduarit e aksidentit të djeshëm të trafikut, ndërsa gjatë ditës 20-25 pacientë do të lirohen për trajtim në shtëpi", tha Samarxhiq më herët gjatë së hënës.

Të dielën dhjetë veta me prejardhje nga Kosova humbën jetën dhe mbi dyzet u lënduan kur autobusi me të cilin udhëtonin, doli nga rruga në qytetin kroat Sllavonski Brod. Autobusi me 67 pasagjerë, përfshirë fëmijë, ishte nisur nga Frankfurti për në Prishtinë. Në pansionin, që ka pranuar udhëtarët që nuk kanë qenë të lënduar nga aksidenti, janë 15 persona.

Autoritetet kroate thanë të hënën se identiteti i tetë viktimit nga aksidenti me autobus në Kroaci tashmë është konfirmuar, kurse për dy të tjerë po vazhdon procesi i identifikimit, sipas policisë në Kroaci.

Gjini: Pesë të vdekur dhe dy të lënduar janë nga Gjakova

Komuna e Gjakovës është rajoni nga ku vijnë gjysma e viktimave të aksidentit në Kroaci. Ardian Gjini, kryetar i Komunës së Gjakovës, tha për "Radion Evropa e Lirë" se pesë të vdekur janë nga Gjakova si dhe dy të lënduar rëndë. Sipas Gjinit, komuna ka formuar një ekip që është në kontakt edhe me familjarët lidhur me informacionin për varrosjen e të vdekurve në aksident. "Familjarët i kam vizituar, por nuk kemi ndonjë informacion se kur pritet kthimi i viktimave. Shumë shpejt do të dalim me një raport [lidhur me çështjen e varrimit të viktimave]", tha Gjini.

Ministrja e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, tha se në organizim e sipër është udhëtimi për në Kosovë i të gjithë atyre që janë në gjendje të udhëtojnë. "Sapo të jenë kryer procedurat e nevojshme, trupat e atyre që humbën jetën në këtë aksident të tmerrshëm, do të sillen në destinacionin e dëshiruar nga familjet e tyre", tha Gërvalla.

Sveçla: Për shoferin do t'i respektojmë ligjet e shtetit kroat

Shoferi i autobusit, 52 vjeç, sipas drejtorit të përgjithshëm të policisë kroate, Nikola Milina, mund të dënohet deri në 15 vjet burgim për veprën penale të shkakimit të një aksidenti trafiku. I pyetur nëse shoferi i arrestuar do të transferohej në Kosovë, ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, të hënën nga Kroacia deklaroi se po presin të gjejnë një zgjidhje. "Ne jemi këtu për t'i respektuar ligjet e Republikës së Kroacisë. Aksidenti ka ndodhur këtu, por ne do të përpiqemi të gjejmë një zgjidhje", ai shtoi.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, shpalli të hënën ditë zie në nderim të viktimave, ndërsa ndërpreu vizitën në Japoni për shkak të aksidentit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, vizitoi të dielën mbrëma të plagosurit në Sllavonski Brod. "Kjo fatkeqësi, kjo tragjedi, është tejet e rëndë për ne", tha Kurti.

Gërvalla, së bashku me kryeministrin Kurti dhe zyrtarë të tjerë të Qeverisë dhe Presidencës

së Kosovës, udhëtuan të dielën drejt Kroacisë.

Disa prej tyre u kthyen tashmë në Kosovë, ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, vazhdojnë të qëndrojnë në Kroaci. Ata janë atje "për t'i koordinuar veprimet dhe të gjitha masat e nevojshme për kujdesin dhe trajtimin e të gjithë udhëtarëve që janë lënduar në këtë aksident tragjik", thuhet në një njoftim të Qeverisë së Kosovës.

Kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenković, tha se është "i trishtuar" dhe "i pikëlluar" nga ngjarja, ndërsa u shprehu ngushëllime familjarëve të viktimave dhe popullit të Kosovës. Presidenti kroat, Zoran Milanović, gjithashtu shprehu ngushëllime dhe uroi shërim të shpejtë për të plagosurit. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës në Kosovë publikoi numrin e telefonit: +383 (0) 38 200 76 000 si kontakt për të gjithë ata që kanë nevojë për informata rreth situatës apo gjendjes së familjarëve në Kroaci. Dhjetëra qytetarë ndezën qirin të dielën mbrëma para Teatrit Kombëtar në Prishtinë në nderim të viktimave të aksidentit.



Katër tragjeditë nga aksidentet me autobusë

PRISHTINË, 26 KORRIK - Që nga mbarimi i luftës në Kosovë në vitin 1999, Kosova ka shënuar dhe përjetuar disa aksidente të tmerrshme që kanë qenë të përfshirë autobusët e udhëtarëve. Në dy dekadat e fundit është rritur transporti rrugor me autobusë nga Kosova për në shtetet e tjera, por janë rritur edhe aksidentet. Më poshtë jua rikujtojmë katër tragjeditë më të mëdha nga aksidentet me autobusë në 20 vjetët e fundit.

Më 2002, dhjetë të vdekur në kufirin Kosovë - Mal i Zi

Dhjetë persona vdiqën, përfshirë edhe dy fëmijë, si dhe 31 të tjerë u lënduan më 25 korrik të vitit 2002 në kufirin Kosovë - Mal i Zi.

Autobusi me 40 udhëtarë ishte duke udhëtuar nga Ulqini për në Kosovë kur doli nga rruga dhe ra poshtë një kodre. Aksidenti ndodhi në orën 05:00. Kjo ishte tragjedia më e madhe rrugore që nga mbarimi i luftës.

Më 2004, 15 maturantë vdesin në Shqipëri

Më 14 tetor 2004, në Fushë-Arrëz të Shqipërisë, vdiqën 15 maturantë kur u aksidentua autobusi me të cilin maturantët po ktheheshin nga ekskursioni në Shqipëri. Autobusi po bartte 49 maturantë kur u rrokullis dhe ra në humnerë. Autoritet thanë se 34 maturantë të tjerë u lënduan, disa prej tyre rëndë. Të 15 maturantët u varrosën në vendin e njëjtë në qytezën e Malishevës, ndërkohë në Fushë-



Arrëz është vendosur një pllakë përkujtimore.

Më 2010, gjashtë të vdekur në një aksident në Austri

Më 22 shkurt 2010 gjashtë persona

nga Kosova vdiqën kur një autobus që udhëtonte nga Prishtina u aksidentua afër Vjenës derisa po udhëtonte për në Gjermani. Aksidenti ndodhi kur autobusi u përplas me dy kamionë në një autostradë në afërsi të kryeqytetit të Austrisë, Vjenë. Në këtë aksident u lënduan edhe mbi 30 persona, disa

prej tyre rëndë. Në aksident vdiqën edhe dy shoferët e autobusit.

Më 2021, dhjetë të vdekur në Kroaci

Më 25 korrik 2021, në një aksident në Kroaci, mbetën të vdekur dhjetë persona me origjinë nga Kosova derisa po udhëtonin në autobusin e linjës Frankfurt - Prishtinë. Mbi 40 persona u lënduan dhe njëri prej tyre vazhdon të jetë në gjendje të rëndë. Autobusi kishte 67 pasagjerë, përfshirë edhe fëmijë. Aksidenti ndodhi në orën 06:00, ku dyshohet se nga pakujdesia e shoferit autobusi doli nga rruga. Policia kroate ka thënë se në kohën e aksidentit shoferin e kishte zënë gjumi. Shoferi është ndaluar nga policia derisa të kryhen hetimet. (Rel)



Pjesëtarët e FSK-së mbajnë trajtimin 'Patrulla luftarake' te liqeni i Batllavës

PODUJEVË, 26 KORRIK (ER) - Komuna e Podujevës ka njoftuar qytetarët se nga data 26 korrik deri më 28 korrik Regjimenti i Tretë i këmbësorisë, Kazerma Minatori, e sistemuar në Mitrovicë, sipas planit vjetor të punës, do ta mbajë trajnimin "Patrulla luftarake - kalimi i zonave ujore" në nivel kompanie.

Zona e realizimit të këtij trajnimi do të jetë komuna e Podujevës, saktësisht hapësirat e liqenit të Batllavës dhe fshati Koliq. "Duke pasur parasysh natyrën e këtij trajnimi, njoftojmë qytetarët se gjatë ditëve sa do të zgjatë trajnimi do të ketë lëvizje të shtuar të personelit dhe automjeteve ushtarake në këtë zonë", ka njoftuar komuna e Podujevës.



Vazhdon implementimi i planit operativ "Siguria në trafik 2021"



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

GJILAN, 26 KORRIK - Policia e Kosovës, njësitet e trafikut rajonal në Gjilan, në vazhden e implementimit të planit operativ "Siguria në trafik 2021", të hënën kanë vazhduar kontrollet e shtuara të veturave dhe mjeteve transportuese me qëllim të preventimit dhe parandalimit të aksidenteve në trafik në rrugën magjistrale Gjilan - Kamenicë, punë kjo që do të vazhdojë edhe në ditët në

vijim. "Sot kryesisht është punuar për identifikimin e kundërvajtësve që bëjnë shkelje ligjore gjatë vozitjes, kryesisht 'tejkalim në vijë të plotë', 'tejkalim i kolonës së disa veturave', 'mospërdorim i rripit të sigurisë' dhe 'përdorim i telefonit gjatë drejtimit të automjetit'", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Vetëm gjatë fundjavës janë shqiptuar gjithsej 240 gjoba të ndryshme, përfshirë edhe konfiskimin e tetë patentëshoferëve në raste të

kundërvajtjeve të ndryshme si "tejkalim në vijë të plotë, tejkalim i shpejtësisë së kufizuar në bazë të shenjave të trafikut" etj. "Policia e Kosovës, njësitet e trafikut rajonal në Gjilan, në vazhdimësi kërkojnë nga pjesëmarrësit në komunikacion që të kenë kujdes maksimal dhe t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e komunikacionit gjatë qarkullimit në rrugë, sepse zero tolerancë do të aplikohet ndaj secilit pa dallim që bie në kundërshtim me ligjin", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në FSK filloi dhurimi vullnetar i gjakut

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Me aktivitetin koordinues të Departamentit të Mjekësisë, në kuadër të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGJ), të hënën në Ministri të Mbrojtjes ka filluar dhurimi vullnetar i gjakut. Personeli i Ministrisë së Mbrojtjes, si ai civil dhe ushtarak, çdoherë iu kanë përgjigjur pa hezitim këtij aksioni, të vetëdijshëm se dhurimi i gjakut do të thotë të shpëtosh një jetë, të ndihmohen pacientët në nevojë të Republikës së Kosovës. "Sigurisht se ky aksion në kohën e

pandemisë që po kalon edhe vendi jonë, merr një rëndësi edhe më të madhe sepse dhurimi i gjakut nga çdo vullnetar, është një akt i dobishëm dhe fisnik. Edhe pse në vllugun e pushimeve vjetore dhe fazës së vaksinimit të personelit, në ditën e parë të aksionit u grumbulluan doza të konsiderueshme të gjakut", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Aksioni i dhurimit vullnetar të gjakut do të vazhdojë edhe në ditët në vijim nëpër të gjitha kazermat e FSK-së. Aksioni vullnetar i dhurimit të gjakut është aktivitet i planifikuar në ministri dhe FSK dhe mbahet dy herë në vit.



Shtyhet mbledhja e Kryesisë së Kuvendit

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Në nderim të viktimave në Kroaci dhe shpalljes ditë

zie, me kërkesë të kryetarit të Kuvendit Glauk Konjufca është shtyrë

mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, e cila është paraparë të mbahet të

hënën. Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit mbahet sot në orën 15:00.



Tri vjet pa veprimtarin Adem Demaçi

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 KORRIK - Të hënën u bënë tri vjet që kur ndërroi jetë veprimtari i çështjes kombëtare, Adem Demaçi, i njohur si Mandela i Kosovës. Me prejardhje nga fshati Lupq i Podujevës, Demaçi lindi më 26 shkurt 1936 në Prishtinë, ndërsa më 26 korrik të vitit 2018 ndërroi jetë. Ai ishte veprimtar për kauzën kombëtare në kohën e Jugosllavisë dhe luftonte për barazinë e Kosovës me republikat e tjera.

Për angazhimin e tij politik, Adem Demaçi vuajti 28 vjet me radhë në burgjet e Jugosllavisë. Pasi u lirua ai menjëherë vazhdoi aktivitetin politik. Ai u quajt edhe Nelson Mandela i Evropës.

Adem Demaçi udhëhoqi Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (KMDLNJ) nga viti 1990 deri në vitin 1995. Në vitin 1991 u nderua nga Parlamenti Evropian me Çmimin Saharov. Gjatë periudhës 1998-1999, kur mbaheshin takimet në Rambouillet për të ardhmen e Kosovës, ai ishte zëdhënës politik i UÇK-së. Ishte njëkohësisht kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (2005-2007).

Sot njerëzit e rezistencës kombëtare identifikohen me emrin e Adem Demaçit, sepse ai me punën dhe me veprën e tij u bë simbol i unifikimit për ruajtjen e kombit shqiptar, mbi pesë dekada.

Adem Demaçi me jetën dhe veprën e tij u shndërrua në një personalitet të përmasave të historisë së përgjithshme njerëzore, ku bën pjesë edhe historia jonë kombëtare. Ai ka

shkruar romanin "Gjarprijt e gjakut" i cili u ndalua nga regjimi ish-komunist. Ai e pa dritën vetëm pas vjetëve nëntëdhjetë.

Pasditen e 26 korrikut të vitit 2018, Demaçi ndërroi jetë. Në nderim të tij u organizuan shumë aktivitete shtetërore si dhe u mbajtën tri ditë zie në Kosovë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në këtë përvjetor ka vënë dhe bërë homazhe para varrit të veprimtarit që jetën ia kushtoi çështjes kombëtare.

Në trevjetorin e vdekjes, Demaçin e ka përkujtuar edhe Partia Demokratike të Kosovës (PDK). Ky subjekt politik ka vlerësuar se Adem Demaçi mbetet në kujtesën kolektive si njeriu i pathyeshëm të cilin nuk e mposhtën as tri burgjet e vuajtura, as persekutimi sistematik. "Tri vjet më parë Kosova humbi kolosin e rezistencës kombëtare, luftëtarin më të paepur për lirinë e mendimit, mbrojtësin më të madh të të drejtave të njeriut, njeriun më revolucionar të shqiptarisë, Adem Demaçin. Siç e pasqyronte jetën e tij në veprën 'Dashuria kuantike e filanit', baca ishte simbol i pashembullt i vetëmohimit për çështjen kombëtare. Adem Demaçi mbetet në kujtesën kolektive si njeriu i pathyeshëm të cilin nuk e mposhtën as tri burgjet e vuajtura, as persekutimi sistematik. Ai e tejkaloi vetveten për t'u bërë dritë në rrugën e popullit të Kosovës drejt lirisë.

Vepra unike e bacës do të jetë përherë drita e këtij populli!", është thënë në një deklaratë të PDK-së. Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka përkujtuar veprimtarin Adem



Demaçi në trevjetorin e vdekjes. Tahiri ka theksuar se Adem Demaçi me zërin kumbues zgjoi kombin kundër robërimit. "Tri vjet kur kolosi i kombit, Adem Demaçi, i takon përjetësisë. Baca Adem me

zërin kumbues zgjoi kombin kundër robërimit, me mendjemprehtësi u bë kambana e rezistencës, me sakrificën udhërrëfyes i shtegtarëve të lirisë. Shumë kombe e popuj jetojnë me

ëndrën t'i kenë prijësit si Baca, neve na mbetet ta ndjekim idealin, jetën dhe veprën e kishte lartësim për popullin dhe atdheun", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurti nderon policin Enver Zymberi në dhjetëvjetorin e rënies në krye të detyrës

VUSHTRRI, 26 KORRIK (ER) - Një buqetë lulesh u vendos të hënën në nderim të veprës së pjesëtarit të forcave speciale të Policisë së Kosovës, i cili më 26 korrik 2011 humbi jetën në krye të detyrës në mbrojtje të sovranitetit të Republikës së Kosovës. Në përvjetorin e dhjetë të rënies në krye të detyrës të Enver Zymberit, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, bëri homazhe te varri i tij. Në vizitë te familja Zymberi në Dubovc të komunës së Vushtrrisë, kryeministri Kurti, me babanë e Enverit, Muharrem Zymberi, rikujtuan ngjarjet e korrikut 2011 dhe bisedat e fundit të Enverit me familjen.

Kryeministri Kurti ka thënë se

Enver Zymberi është shembulli më domethënës i policëve tanë të cilët janë të gatshëm të japin gjithçka, edhe jetën, për sigurinë e Kosovës e të qytetarëve të saj.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar policin Enver Zymberi. "Dhjetë vjet nga rënia heroike e pjesëtarit të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës, Enver Zymberi. Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit të vendit, siguria e qytetarëve dhe mbrojtja e rendit dhe ligjit, për Enverin ishin përtej jetës së tij.

Kosova dhe qytetarët e saj do të kujtojnë përgjithmonë me respekt dhe përlujë heroin Enver Zymberi", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Punëtorët e ATK-së hyjnë në grevë me orar të plotë

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Sindikata e Punëtorëve e Administratës Tatimore të

Kosovë (ATK) ka marrë vendim që nga dita e hënë ta vazhdojnë grevën e tyre me

orar të plotë nga ora 08:00 deri në orën 16:00. Me hyrjen në grevë do të ndërpriten të gjitha

shërbimet për tatimpaguesit nga të gjitha zyrat dhe regionet e ATK-së.



Rukiqi: Mungesa e fuqisë punëtore, shqetësuese

PRISHTINË, 26 KORRIK - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, gjatë paraqitjes të indikatorëve matës me të gjeturat kryesore nga anketimi i bizneseve për tremujorin e parë të vitit 2021, ka thënë se mbetet shqetësuese konkurrenca jolojale dhe mungesa e punëtorëve në këtë kohë. Sipas tij, të gjithë indikatorët tregojnë se gjendja e bizneseve është përmirësuar pas një viti ballafaqimi me pandeminë Covid-19.

Rukiqi ka thënë se rreth 61 për qind e bizneseve kanë vlerësuar se situata e tyre binzesore në gjashtë muajt e ardhshëm do të përmirësohet. "Si problem në këtë periudhë ka vazhduar të jetë mungesa e porosive. Pra, ka pasur një kërkesë më të ulët për mallra dhe shërbime. Gjithashtu, është vërejtur edhe mungesa e mjeteve financiare e bizneseve. Shumë çështje kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt me rrjedhën e parasë. Shqetësuese mbetet konkurrenca jolojale. Tani në sezonin e verës si problematikë të bizneset është mungesa e punëtorëve. Do të thotë, shumë kompani ankohen për mungesë të punëtorëve", ka thënë Rukiqi.



Ai ka bërë thirrje që të trajtohet si problem mungesa e punëtorëve. "Puna është shtuar dukshëm si rezultat i ardhjes së diasporës. Si rrjedhojë e hapjes së ekonomisë

ne duhet si shoqëri ta trajtojmë këtë problem me shumë seriozitet në muajt dhe vitet në vijim. Pra, jo vetëm në kuptim të mungesës së fuqisë punëtore të

kualifikuar, por edhe në mungesë të fuqisë punëtore në numra", ka deklaruar Rukiqi. Ai ka përmendur se në muajin shtator pritet të shtohen aktivitetet në

masë më të madhe nga Oda Ekonomike e Kosovës. Rukiqi ka thënë se në fund të muajit shtator do të mbahet edhe një panair me biznese.

Nuk merr mbështetje raporti mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Kosovës për vitin 2021



PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të hënën, të kryesuar nga Adnan Rustemi, kryetar.

Në këtë mbledhje, pas prezantimit të zëvendësministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu, janë miratuar në parim Projektligji nr. 08/L-013 për të Drejtat pronësore të shtetasve të

huaj në Republikën e Kosovës dhe Projektligji nr. 08/L-017 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, me rekomandimin për miratim në lexim të parë në një nga seancat e radhës. Kurse nuk i është dhënë mbështetje raportit me amendamente të komisionit funksional në Projektligjin nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

BE-ja i shpall luftë pastrimit të parave

PRISHTINË, 26 KORRIK - Çdo vit në ekonominë e rregullt futen shuma të mëdha parash me prejardhje të paligjshme ose nga kontrabanda. Njëpërmjet një reforme gjithëpërfshirëse Bashkimi Evropian synon të luftojë më intensivisht

pastrimin e parave. "Rregullat tona kundër pastrimit të parave janë më të ashprat në botë, por tani ato edhe duhet të zbatohen me konsekuencë", ka thënë nënkryetari i Komisionit të BE-së, Valdis Dombrovskis. Kjo ka munguar në vitet e

fundit. Shumë shtete anëtare të BE-së nuk i zbatojnë në praktikë rregullat ose janë tepër të dobët në mbikëqyrjen dhe rishikimin e transaksioneve financiare të dyshimta. Prandaj, Komisioni Evropian po propozon tani zyrtarisht atë

që është përgatitur në Bruksel prej muajsh: që një autoritet i ri mbikëqyrës i BE-së t'i mbikëqyrë vendet anëtare dhe të monitorojë dhe kontrollojë vetë institucionet e mëdha financiare ndërshtetërore që paraqesin rreziqe.





SALVATORE QUASIMODO

POETI DHE POLITIKANI

Ligjërata e Nobelit, 11 dhjetor 1959

“E gjatë është nata që kurrë nuk e gjen ditën”. Këto janë fjalët e Shekspirit të Makbethi dhe ato na ndihmojnë ta përcaktojmë gjendjen e poetit. Në radhë të parë lexuesi i duket poetit në vetminë e tij si një imazh me fytyrën dhe gjestet e një miku fëmijë, mbase të atij miku më të ndjeshëm që ka përvojë në leximet vetmitare, por paksa të druajtshëm për vlerësimin e paraqitjes së supozuar, apo të keqinterpretimit të botës. Ky prezantim provohet me masa të ashpra poetike të huaja për shkencën dhe me fjalët tingujt e të cilave janë të paracaktuara.

Një dyfishim i saktë poetik i një njeriu është për poetin mohim i tokës, një pamundësi e të qenit, ndonëse dëshira e tij më e madhe është të flasë me shumë njerëz, t'i bashkojë ata me anë të vargjeve harmonike lidhur me të vërtetat e mendjes apo të gjërave. Pafajësia është nganjëherë një veti akute që lejon prezantimin më të madh të së arsyeshmes. Dhe, pafajësia e mikut të poetit, që kërkon, dialektikisht, që ritmet e para poetike të kenë një formë logjike, do të mbetet një pikë e ngulitur e referencës, një fokusim që do t'i bëjë të mundur poetit të ndërtojë një gjysmë parabolë. Lexuesit e tjerë të

poetit janë poetët antikë të cilët i shikojnë faqet e porsashkuara nga një distancë e pakorruptueshme. Format e tyre poetike janë të përhershme dhe është vështirë të krijosh forma të reja që mund t'u afrohen atyre.

Shkrimtari i tregimeve apo i romaneve përcaktohet për njerëzit dhe i imiton ata; ai shter mundësitë e karaktereve të tij. Poeti është i vetmuar me objekte të pafundme në sferën e tij të mjegullt dhe nuk e di nëse ai duhet të jetë indiferent apo shpresëdhënës. Më vonë, kjo fytyrë e vetme do të shumëfishohet; ato gjeste do të bëhen opinione miratuese apo jomiratuese. Kjo ndodh me botimin e poezive të para. Ashtu siç ka pritur poeti, alarmet bien tani, ngaqë - dhe kjo duhet të thuhet sërish - lindja e një poeti është gjithmonë një kërcënim për rendin ekzistues kulturor, sepse ai përpiqet të depërtojë në rrethin e kastave letrare për të arritur në qendër.

Ai tani ka një publik të çuditshëm me të cilin ai fillon të ketë një raport të heshtur dhe armiqësor: kritikët, profesorët provincialë, njerëzit e letrave. Në rininë e poetit, shumica e këtyre personave shkatërrojnë metafizikën e tij, përmirësojnë imazhet e tij. Ata janë gjykatës

abstraktë që revidojnë poezitë “e gabuara” sipas një standardi indiferent poetik.

Poezia është edhe vetja fizike e poetit dhe është e pamundur ta ndash poetin nga poezia e tij. Megjithatë, nuk do të hyj në autobiografi duke folur për vendin tim, i cili, siç e di secili, ka qenë i mbushur çdo shekull me Giovanni Della Casas, do të thotë, me njerëz të letrave të pastërtisë metrike dhe me zotësi plotësisht të zhvilluara. Këta priftërinj të lartë të traditës kanë mprehtësi dhe imagjinatë. Për më tepër, ata janë të obsesionuar me alegoritë e shkatërrimit të besueshëm të botës. Ata nuk durojnë kronikat, por vetëm figurat dhe qëndrimet ideale. Për ta, historia e poezisë është një galeri fantazmash. Madje edhe polemika ka ndonjë justifikim nëse kemi parasysh se edhe eksperimentet e mia të para poetike filluan gjatë kohës së diktaturës dhe shënojnë burimin e lëvizjes hermetike.

Që nga libri im i parë, i botuar më 1930, deri tek i dyti, i treti dhe i katërti (një përkthim i lirikës greke, botuar më 1940), ia dola të shihja vetëm një publik të shtresuar të lexuesve modestë apo ambiciozë përmes mjegullnajës politike dhe aversionit akademik ndaj

poezisë së ashpër që u hoq nga kompozicioni standard klasik. Lirici Greci (1940) [Lirikë greke] hyri e freskët dhe e re në brezin letrar të kohës dhe kjo iniciei një lexim më të vërtetë të klasikëve në tërë Evropën. E dija se të rinjtë citonin vargje nga lirika ime në letrat e tyre të dashurisë; të tjera shkruheshin mbi muret e burgjeve nga të burgosur politikë. Ç'kohë për të shkruar poezi! Ne shkruanim vargje që na gjykonin, pa shpresë për falje, në vetminë më të hidhur. A ishin këto vargje kategori të shpirtit - të vërteta të mëdha? Poezia tradicionale evropiane, akoma e pakufizuar, nuk ishte e njohur me praninë tonë: krahina latine, nën mbrojtjen e cesarëve të saj, ushqente gjakderdhjen, jo leksioni për humanizmin.

Lexuesit e mi të asaj kohe ishin ende njerëz të letrave, por duhej të kishte edhe njerëz të tjerë që prisnin për t'i lexuar poezitë e mia. Studentë, punëtorë jakëbardhë, proletarë? Po të kisha kërkuar vetëm një të ngjarë abstrakte në poezinë time? Apo, kisha filluar duke qenë tepër pretencioz? Përkundrazi, unë isha një shembull se si thyhej vetmia? Vetmia, “nata e gjatë” e Shekspirit, e padurueshme për politikanin - i cili dëshironte një

poet si Tirteu gjatë fushatave afrikane apo ruse - u bë qartë poetike, duke simbolizuar vazhdimin e dekadencës evropiane, si një skicë e vrazhdë e neohumanizmit. Lufta, kam thënë gjithmonë, i detyron njerëzit t'i ndryshojnë standardet e tyre pa marrë parasysh nëse vendi i tyre ka fituar apo ka humbur. Poetika dhe filozofitë çintegrohen “kur drunjtë bien dhe muret rrëzohen”. Në pikën kur vazhdimësia u ndërpre nga shpërthimi i parë bërthamor, do të kishte qenë fare lehtë të rikthehej sedimenti që na lidhte me një epokë të dekorit poetik, të një preokupimi me tingujt poetikë. Pas trazimit të vdekjes, parimet morale, madje edhe dëshmitë religjioze vihen në dyshim. Njerëzit e letrave që iu qepen suksesëve private të estetikës së tyre të vogël mbyllen ndaj pranisë trazuese të poezisë. Nga nata, vetmia e tij, poeti gjen ditën dhe fillon një ditë që është vdekjeprurës për inerten. Peizazhi i errët i hap udhë dialogut. Politikani dhe poetët mediokër, me parzmën e tyre të simboleve dhe finesave mistike, mëtojnë ta injorojnë poetin e vërtetë. Ky është një tregim që përsëritet si sorra e trapit, në të vërtetë, si sorra e tretë e trapit.

Poeti është një jokonformist dhe nuk depërton dot guacën e qytetërimit të rrejshëm letrar, që është përloft frëngji mbrojtëse, si në kohën e bashkësive. Ai duket se po i shkatërron format e tij, kurse në të vërtetë ai i vazhdon ato. Ai kalon nga poezia lirike tek ajo epike që të mund të flasë për botën dhe vuajtjen në botë përmes njeriut, racionalisht dhe emocionalisht. Poeti atëherë bëhet i rrezikshëm. Politikani gjykon lirinë kulturore me dyshim dhe me anë të kritikës konformiste apo përpiqet ta bëjë të palëvizshëm vetë konceptin e poezisë. Ai sheh aktin krijues si jashtëkohor dhe të paefektshëm brenda shoqërisë, sikur poeti, në vend se të ishte njeri, të ishte vetëm një abstraksion.

Poeti është shuma totale e “përvojave” të ndryshme të njeriut të kohës së tij. Gjuha e tij nuk është më ajo e avangardës, por është konkrete në kuptimin klasik. Elioti ka vënë në pah se gjuha e Dantes është “përsosje e një gjuhe të zakonshme... megjithëqë, ‘stili i thjeshtë’, mjeshtri më i madh i së cilës është Dante, është një stil shumë i rëndë”. Gjuhës së poetit duhet dhënë theksin e duhur. Ajo nuk është as gjuha e parnasianëve, as ajo e revolucionarëve gjuhësorë, sidomos në vendet ku ndotja nga dialektet vetëm sa prodhon dyshime të mëtejme dhe hieroglifë letrarë. Në të vërtetë, filologët nuk do të ringjallin kurrë një gjuhë të shkruar. Kjo është një e drejtë që i takon ekskluzivisht poetit. Gjuha e tij është e vështirë jo për shkak të arsyeve filologjike, apo të territ shpirtëror, por për shkak të përmbajtjes së saj. Poetët mund të përkthehen, njerëzit e letrave jo, sepse ata përdorin mjeshtri intelektuale për t’i kopjuar metodat e poetëve të tjerë dhe për ta mbështetur simbolizmin apo dekadencën pikërisht për shkak të mungesës së përmbajtjes, për shkak të mendimit të tyre të prejardhur, për të vërtetat nga të cilat ata janë ushqyer teori-kisht kur shihet se i ngjajnë Gëtes apo poetëve të mëdhenj frëngë të shekullit nëntëmbëdhjetë. Një poet i qepet traditës së vet dhe i shmanget internacionalizmit. Njerëzit e letrave e mendojnë Evropën, apo madje edhe tërë botën në dritën e një poetike që izolon veten, sikur poezia të ishte një “objekt” identik në tërë botën. Pastaj, me këtë të kuptuar të poetikës, njerëzit formalistë të letrave mund të parapëlqejnë lloje të caktuara të përmbajtjes dhe i refuzojnë të gjitha të tjerat me forcë. Por problemi nga asnjëra anë e barrikadës nuk është gjithmonë përmbajtja. Kështu, bota e poetit zë të bie me forcë në zemrat e të gjithë njerëzve, kurse njerëzit absolutë të letrave mendojnë se vetëm ata jetojnë një botë reale. Sipas tyre, poeti është i kufizuar në provinca me gojën e tij të thyer

në trapezin e vet silabik. Politikani shfrytëzon përparësinë e njerëzve të letrave që nuk marrin një pozitë bashkëkohore shpirtërore, por një pozitë që është e vjetruar nga, të paktën, dy breza. Nga uniteti kulturor, ai bën një lojë të dekompozimit të sofistikuar, të trazuar ku forcat religjioze ende mund të bëjnë presion për robërimin e inteligjencës së njeriut.

Poezia religjioze, poezia qytetare, lirike, apo poezia dramatike, kanë të gjitha kategori të të shprehurit të njeriut dhe që vlejnë vetëm nëse miratimi i përmbajtjes formale është i vlefshëm. Është gabim të mendohet se një pushtim shpirtëror, një situatë e caktuar emocionale (një gjendje religjioze) e individit, mund të shndërrohet në “shoqëri” përmes zgjerimit. Mohimi fanatik, refuzimi i njeriut nga njeriu, nuk është asgjë pos një formulë vdekjeje. Shpirti i vërtetë krijues bie gjithmonë në kthetrat e ujqve. Diskursi i folur i poetit varet shpesh nga mistikja, nga liria shpirtërore që është e robëruar në tokë. Ai tmerron bashkëbiseduesin e vet (hijen e vet, një objekt që duhet disiplinuar) me imazhe të dekompozimit fizik, me analiza të vetëkënaqësisë së lemerishme. Poeti nuk ka frikë nga vdekja, jo ngaqë beson në fantazinë e heronjve, por ngaqë vdekja viziton vazhdimisht mendimet e tij dhe është kështu një imazh i dialogut gjakftohtë. Në kundërshtim me këtë shkëputje, ai gjen një imazh të njeriut që përmban në vete ëndrrat e njeriut, sëmundjet e njeriut, shpëtimin e njeriut nga mjerimi i varfërisë - varfërisë që nuk mund të jetë më për të shenjë e pranimit të jetës.

Në mënyrë që të vlerësohet gjerësia e pushtetit të politikani - dhe këtu përfshihet edhe pushteti religjioz - kemi nevojë vetëm ta rikujtojmë heshtjen që zgjati për një milenium në fushat e poezisë dhe të artit pas përfundimit të epokës klasike, apo t’i rikujtojmë pikturat e mëdha të shekullit pesëmbëdhjetë, një periudhë në të cilën Kisha ndihmonte veprën dhe diktonte përmbajtjen e saj.

Kritika formaliste përpiqet ta godasë konceptin e artit duke përqendruar sulmin e vet mbi format. Ai shpreh rezervime ndaj konsekuencës së përmbajtjes që të mund ta cenojë autonominë artistike në një kuptim absolut. Në fakt, poezia nuk do t’i pranojë përpjekjet “misionare” të politikani, apo ndonjë formë tjetër të ndërhyrjes kritike, nga çfarëdo filozofie që mund të burojë ajo. Poeti nuk devijon nga shtegu i tij moral apo estetik, prandaj edhe vetmia e tij është e dyfishtë përballë botës dhe milicive letrare.

Por, a ka estetikë

bashkëkohore? Dhe, çfarë filozofie ofron sugjerime vërtet me peshë? Një poezi ekzistencialiste, apo marksiste, ende nuk ka dalë në horizontin letrar; dialogu filozofik, apo kori i brezave të rinj, nënkupton një krizë, madje nënkupton edhe krizën te njeriu. Politikani shfrytëzon këtë konfuzion për t’i dhënë hapësirë stabilitetit iluzor ndaj poezisë së fragmentuar.

Antagonizmi midis poetit dhe politikani zakonisht është i dukshëm në të gjitha kulturat. Sot të dy blloqet që sundojnë botën ushqejnë koncepte të kundërta të lirisë, ndonëse është e qartë se për politikani nuk ka pos një lloj të lirisë, që çon në një drejtim të vetëm. Është vështirë të thuhet kjo barrierë, që ka njosur historinë e qytetërimit me gjak. Ekzistojnë gjithmonë të paktën dy mënyra të kundërimit të lirisë kulturore: liria që gjendet në atë vende ku ka ndodhur një revolucion i thellë shoqëror (Revolucioni Frëng, për shembull, apo Revolucion i Tetorit) dhe ai që gjendet në vende të tjera, që me kokëfortësi i rezistojnë ndërmarrjes të çfarëdo reforme në botëkuptimin e tyre.

A mund të bashkëpunojnë poeti dhe politikani? Ndoshta do të mundnin në shoqëritë që nuk janë zhvilluar ende plotësisht, por kurrë në lirinë e plotë të të dyve. Në botën bashkëkohore politikani mund të marrë qëndrime të ndryshme, por një pajtim midis poetit dhe politikani nuk do të jetë kurrë i mundur, ngaqë njëri merret me rendin e brendshëm të njeriut, kurse tjetri me urdhërimin e njerëzve. Një kërkim për rendin

e brendshëm të njeriut në një epokë të caktuar do të mund të rastiste me urdhërimin dhe ndërtimin e një shoqërie të re.

Pushteti religjioz që, siç kam thënë më parë, identifikohet shpesh me pushtetin politik, ka qenë gjithmonë një protagonist i kësaj beteje të hidhur, madje edhe kur në dukje ishte neutral. Arsyet për të cilat poeti, si barometër moral i popullit të vet, bëhen rrezik për politikani janë gjithmonë ato që Giovanni Villani i citon në Croniche Fiorentine. Ai thotë këtu se, për të mirën e bashkëkohësve të tij, Dante, si poet shkrihej nga gëzimi me deklamime dhe përçartje në komedinë e tij, mbase më shumë nga ç’kishte nevojë, por ka mundësi që për këtë fajin e kishte mërgimi i tij.

Ndryshe nga Villani, Dante nuk shkruan kronika. Poezisë së shkëlqyer “hermetike” të dolce stil nuovo Dante më vonë i shton, pa tradhtuar asnjëherë integritetin e tij moral, dhunën e sharjes njerëzore dhe politike, jo të diktuar nga aversionet e tij, por nga standardi i tij i brendshëm i drejtësisë, që është religjioz në kuptimin universal. Estetët i kanë vënë me shumë kujdes këto vargje, që digjen në përjetësi, në ngërçin e jopoezisë. Vargjet si Trivia ride tra le ninfe eterne (Trivia buzëqesh mes nimfash të përjetshme) janë dukur gjithmonë vetëm nëse ai mbetej vazhdues i iluminizmit pseudo-ekzistencial, dekorues i ndjenjave të qeta njerëzore, apo nëse ai nuk depërton tepër thellë në dialektikën e kohës së tij, qoftë nga frika e politikës, qoftë thjesht nga inercia. Për shembull, Angelo Poliziano në

shekullin pesëmbëdhjetë tregonte lirinë e tij artistike në njëren prej Stanze per l’agiostro di Ginliano de’ Medici [Stanza të shkruara për kalorësin Medici], ku ai flet me kujdes për një nimfë të ngatërruar, që shkon në meshë me zonja laike. Por Leonardo da Vinçi, shkrimtar i një lloji tjetër, nuk ishte i lirë. Këtu liria mes kuptimit të vet të vërtetë; ajo nuk është asgjë pos një leje e dhënë nga pushteti politik që i lejon poetit të hyjë në shoqërinë e tij i paarmatosur. Madje as Ariosto dhe Tasso nuk ishin të lirë dhe as Abbot Parini, as Alfieri, as Foscolo: retorika e këtyre burrave të persekutuar i vë ata në kohë në mesin e propaguesve të zërit të njeriut - një zë që duket sikur qan në shkretëtirë dhe kështu gërryen të pavërtetat e shoqërisë.

Po, a është politikani i lirë, nga ana e tij? Jo. Në fakt, kastat që e rrethojnë atë përcaktojnë një fat të shoqërisë dhe veprojnë madje edhe mbi diktatorin. Rreth këtyre dy protagonistëve të historisë, që të dy armiq dhe asnjëri prej tyre i lirë - dhe me poetë ne mendojmë të gjithë shkrimtarët e rëndësishëm të një epoke të caktuar - trazohen pasionet dhe zhvillohet konflikti. Dhe, paqe ka vetëm në kohë lufte apo revolucion - revolucioni si bartës i rendit dhe lufta si bartëse e konfuzionit.

Lufta e fundit ishte përplasja e sistemeve, e politikës, e rrethave civile, komb më komb. Dhuna e saj përdrodi edhe liritë më të vogla. Një ndjenjë e jetës u riparaqit mu në rezistencën ndaj invaduesit armiqësor, por të njohur, një rezistencë e kulturës dhe humanizmit popullor, i cili, me fjalët e Virgilit, “çoi kokë në fushat e hidhura” kundër të pushtet-shmit.

Në çdo vendnjë traditë kulturore mbetet e pashkëputur nga kjo lëvizje ushtarake. Kjo traditë nuk është vetëm e përkoh-shme, ndonëse konsiderohet si e tillë nga bankierët konser-vativë që financojnë ndërtimin e “palëkundshmërive” të qytetërimit. Unë këmbëngul në thënien ‘jo vetëm e përkoh-shme’, ngaqë thelbi i kulturës bashkëkohore (përfshirë filozofinë e ekzistencës) është i orientuar jo drejt shkatërrimeve të shpirtit dhe mendjes, por drejt një përpjekjeje për t’i riparuar kocat e thyera të njeriut. As frika, as mungesa, as indiferenca, as pafuqia nuk do ta lejojnë kurrë poetin t’ua komunikojë fatin jometafizik të tjerëve.

Poeti mund të thotë se njeriu fillon sit, politikani mund të thotë, dhe në të vërtetë këtë bën, se njeriu ka qenë dhe do të jetë gjithmonë në kurthin e themelit të vet moral, një themel që nuk është i lindur, por që mishërohet nga një infektim i ngadalshëm laik.





Kjo e vërtetë, e fshehur në mesin e qëndrimeve të paarrishme të urtësisë politike sugjeron, si konkludim i parë, se poeti mund të flasë vetëm në periudha anarkie. Rezistenca është një siguri morale dhe jo poetike. Poeti i vërtetë nuk përdor kurrë fjalët që të dënojnë dikë. Gjykimi i tij i takon rendit krijues. Ai nuk formulohet si shkrim profetik.

Evropianët e dinë rëndësinë e rezistencës. Ajo ka qenë shembulli i shkëlqyer i ndërgjegjes moderne. Armiku i rezi-stencës, me tërë britmat e tij, është sot vetëm një hije, pa ndonjë fuqi. Zëri i tij është më jopersonal sesa propozimet e tij. Ndjesia popullore nuk mashtrohet me pozitën e poetit apo me atë të kundërshtarit të tij. Me rritjen e antagonizmit, poezia i zë vendin mendimit vartës të politikanit që e shndërron poezinë në një ide që mund të shfrytëzohet apo të shuhet.

Rezistenca është imazhi i përkryer i konfliktit midis së tashmes dhe së kaluarës. Gjuha e gjakut nuk është vetëm një dramë në kuptimin fizik, ajo është shprehje definitive e një gjykimi të vazhdueshëm të "teknologjisë" morale të njeriut. Evropa u lind nga rezistenca dhe nga admirimi i figurave të papërcaktuara që i takojnë atij rendi që lufta ka kërkuar të

krijojë. Këto figura tani janë shkëputur nga rrënjët. Vdekja ka një gjumë autonom dhe çdo ndërhyrje për ta prishur këtë gjumë, qoftë nga logjika, apo nga mjeshtëria e mençurisë politike, është çnjerëzore. Besnikëria e poezisë qëndron përtej çfarëdo konsiderate të padrejtësisë apo qëllimeve të vdekjes. Politikani dëshiron që njerëzit të dinë si të vdesin trimërisht; poeti dëshiron që njerëzit të jetojnë trimërisht.

Derisa poeti është i vetëdijshëm për pushtetin e politikanit, politikani e vëren poetin vetëm kur zëri i tij arrin thellë në shtresat e ndryshme shoqërore, do të thotë kur përmbajtja lirike apo epike zbulohet ashtu si dhe forma poetike. Në këtë çast, një betejë nëntokësore fillon midis politikanit dhe poetit. Në histori emrat e poetëve të mërguar trajtohen si zare njerë-zore, ndërkohë që politikani pohon ta mbështesë kulturën por, në fakt, përpiqet vetëm ta zvogëlojë fuqinë e saj. Qëllimi i tij i vetëm, si gjithmonë, është ta deprimojë njeriun nga tri a katër liri fundamentale, në mënyrë që në ciklin e tij të përgjeshëm njeriu të nxjerrë vazhdimisht atë që i është marrë.

Në kohën tonë, mbrojtja e politikanit ndaj kulturës dhe kështu ndaj poetit funksionon

fshehurazi dhe hapur në mënyra të shumëfishta. Mbrojtja e tij më e lehtë është degra-dimi i konceptit të kulturës. Mjetet mekanike dhe shkencore, radio dhe televizioni, ndihmojnë për t'hyerjen e unitetit të arteve, për të favorizuar një poetikë që nuk do t'i trazojë qoftë edhe hijet. Poetika e tij më e dashur është gjithmonë ajo që shoqërohet me kujtimin e Arkadias për nënvlerësimin artistik të epokës së vet. Ky është kuptimi i vargut të Eskilit, "unë besoj se të vdekurit vrasin të gjallët", që unë e kam përdorur si epigraf në veprën time të fundit, La terra impareggiabile. Në këtë libër njeriu krahasohet me tokën. Nëse është mëkat të flitet për mendjehollësinë e njeriut, ne mund të themi se pushteti religjioz - dhe mbiemri "laik", i përdorur për të cilësuar inteligjencë, ka për qëllim të tregojë jo një cilësi të rastësishme, por një vlerë të brendshme - shkon tepër larg kufijve të tij kur përdor fuqinë e vet për t'i shtypur të vegjlit më shumë sesa për t'u marrë me zjarrin e brendshëm të ndërgjegjes.


Shtrembërimi i konceptit të kulturës që iu ofrohet masave, që i bën të besojnë se ata po kapin një dritësim të parajsës së diturisë, nuk është mjet modern politik, por metodat e përdorura për këtë shthurje të shumëfishtë

të interesave meditative të njeriut janë të reja dhe efektive. Optimizmi është bërë një artikull i prekshëm. Ai nuk është asgjë, pos një lojë kujtese. Mitet dhe tregimet (ankthi mbi ngjarjet e mbinatyr-shme, të themi) jo vetëm që zbresin në nivelin e mistereve të vrasjes, por edhe pësojnë metamorfoza të dukshme në kinema apo në rrëfimet epike të kriminelëve dhe të pionierëve. Çdo zgjedhje midis poetit dhe politikanit parandalohet. Urbanizmi elegant, që nganjëherë mëton të jetë indiferent, kufizon ironikisht kulturën në skajet më të errëta të historisë së saj, duke afirmuar se skena e konfliktit është dramaturgizuar, se njeriu dhe vuajtja e tij kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë në kufijtë e tyre të zakonshëm, dje, si dhe sot e nesër. Pa dyshim. Poeti e di se drama ende është e mundur sot - një lloj provokative e dramës. Ai e di se lajkatarët e kulturës janë, gjithashtu, piro-manët e saj. Kolazhi i përbërë nga shkrimtarë në çdo regjim korrupton grupet letrare në qendër, ashtu si dhe në periferi. Grupet e mëparshme mëtojnë pavdekësinë me një kaligrafi vulgare të shpirtit, që ato e stolisin me ngjyrat e jetëve të tyre të pamundshme mendore. Në çaste të caktuara të historisë, kultura fshehurazi bashkon forcat kundër politikanit. Por ky është

një bashkim i përkohshëm, që shërben si një tokmak goditës për t'i rrahur dyert e diktaturës. Kjo forcë krijohet nën çdo diktaturë kur koincidon me një kërkim të lirive fundamentale të njeriut. Kur diktatori të jetë mposhtur, ky bashkim tretet dhe fraksionet lindin prapë. Poeti është i vetmuar. Përreth tij ngrihet një mur i urrejtjes i ndërtuar nga gurët e hedhur nga mercenarë letrarë. Poeti kundron botën nga maja e këtij muri, pa zbritur asnjëherë as në vendet publike, si bardët endacakë, apo në qarqet e sofistikuara, si njerëzit e letrave. Mu nga kjo kullë e fildishtë, aq e dashur për korruptuesit e shpirtit romantik, ai hyn në mesin e njerëzve jo vetëm në nevojat e tyre emocionale, por edhe në mendimet e tyre xhelozë politike.

Kjo nuk është vetëm retorikë. Tregimi i poetit që i nënshtrohet rrethimit të heshtur gjendet në të gjitha vendet dhe në të gjitha kronikat e njerëzimit. Por njerëzit e letrave, që mbajnë anën e politikanit, nuk përfaqësojnë tërë kombin; ata shërbejnë vetëm - them "shërbejnë" - për ta vonuar për disa çaste zërin e poetit në botë. Me kohë, sipas Leonardo da Vinçit, "çdo gabim përmirësohet".

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Avni Spahiu)



KOSOVA SIGURON MEDALJEN E DYTË TË ARTË NË 'TOKIO 2020', PENSIONOHET NGA XHUDOJA 'MBRETËRESHA' MAJLINDË

KRENARIA E KOSOVËS

Nora Gjakova e ka fituar medaljen e dytë të artë për Kosovën në 'Tokio 2020', kurse kjo është medalja e tretë në historinë e Lojërave Olimpikë për Kosovën, pasi një të tillë e kishte fituar Majlinda Kelmendi në "Rio 2016". Në ditën e këtij suksesi historik, "mbretëresha" e xhudos, Majlinda Kelmendi, vendosi t'i japë fund karrierës në xhudo

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 KORRIK - Data 26 korrik për Kosovën do të jetë historike, pasi Nora Gjakova e ka fituar medaljen e dytë në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020", derisa kjo është medalja e tretë e artë për Kosovën në Lojërat Olimpikë

pasi që në olimpiadën e Rios e kishte fituar Majlinda Kelmendi. Xhudistja Gjakova e ka fituar medaljen e artë olimpikë, pasi në finale deri në 57 kilogramë e mposhti Sarah Leoine Cysiquen. Nora deri te finalja i kishte tri fitore. Ishte bartëse e tretë, por shkoi deri në fund. Në luftën e parë xhudistja nga Peja e



Xhudistet tona po arrijnë majat që shumë shtete i kanë ëndërruar. Ato janë epiteti më i mirë i Kosovës të ditëve tona. Përzemërsisht, ju faleminderit!", ka thënë presidentja Osmani. Suksesin e xhudisteve të Kosovës e ka përshëndetur edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjofca, si dhe drejtuesit e partive opozitare dhe të organizatave sportive. Të hënën ka garuar edhe vëllai i Norës, Akil Gjakova, i cili nuk arrin të hyjë në gjysmëfinale. Pas një lufte të ashpër, Akili pësoi humbje nga mongolezi Tsogtbaatar Tsend-Ochir. Xhudisti i Kosovës pësoi humbje edhe në repesazh me shënim të artë nga Rustam Orujov i Azerbajxhanit. Ndërkohë "mbretëresha" e xhudos dhe e sportit të Kosovës, Majlinda Kelmendi, të hënën bëri me dije për vendimin e saj për pensionim. "Për mua kjo ka qenë gara e fundit. Nuk kam pritur që gara e fundit në karrierë do të shkojë kështu. Ishte e shkruar. Krejt i kam fituar. I kam sjellë Kosovës mjaft emocione, mjaft lot. Është radha e tjerëve. Do të jem afër Tonit me u mundu me nxjerrë talente të tjera prej Kosovës", ka deklaruar Kelmendi. Xhudistja e fundit që është në garë për medalje, Lorina Kuka, do të garojë të enjten.



mposhti Sanne Verhagen të Holandës. Më pas ajo fitoi ndaj sllovenes Kaja Kajzer. Në gjysmëfinale arriti fitoren ndaj kundërshtares japonezes Tsukasa Yoshida, kurse në finale e mposhti Sarah Leoine Cysiquen. "Me kampionen numër tre olimpikë për popullin shqiptar. Kosova mbi të gjitha", ka shkruar në profilin e vet në "Facebook", trajneri Driton Kuka. Suksesin e Norës e ka përshëndetur edhe kryeministri i vendit, Albin Kurti. Ai ka thënë se në këtë ditë hidhërimi zemrat e qytetarëve të Kosovës janë lehtësuar nga suksesi i kampiones Nora Gjakova. "Në

këtë ditë hidhërimi, teksa vajtojmë për humbjen e jetëve nga aksidenti tragjik në Kroaci, zemrat tona janë lehtësuar nga suksesi i kampiones sonë, Nora Gjakova, në #Tokyo2020, e cila fitoi të artën në kategorinë e femrave - 57 kilogramë", ka thënë Kurti. Ndërsa presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se në këtë ditë zie për popullin tonë, Nora Gjakova i solli dritë Kosovës. "Në këtë ditë zie për popullin tonë, Nora Gjakova i solli dritë Kosovës. Faleminderit Nora e artë, që duke ecur rrugës së Majlindës e Distrias, po i jepni motiv një populli të tërë për t'u ringritur edhe në vështirësi.

Akil Gjakova: Erdha për medalje olimpikë, por vendi i shtatë s'është edhe i keq

PRISHTINË, 26 KORRIK - Akil Gjakova ka thënë se synimi i tij primar ishte një medalje olimpikë në Lojërat Olimpikë Tokio 2020, por u nda i kënaqur sadopak me vendin e shtatë në kategorinë deri në 73 kilogramë. Akili dështoi të fitojë medalje në Lojërat Olimpikë Tokio 2020, pasi u mund nga Rustam Orujov në gjysmëfinale të repesazhit të hënën. Xhudisti nga Azerbajxhani e mundi kosovarin në luftë për një vend në finale për medaljen e bronzitë në kategorinë deri në 73 kilogramë në Tokio. Këtu edhe morën fund përpjekjet

e kampionit evropian për medalje olimpikë. "Nuk jam shumë i kënaqur edhe pse paraqitjen e kam pasur të mirë. Kam ardhur për të marr medalje dhe duke pasur parasysh që jam kampion evropian, edhe synimi im ka qenë medalja. Por vendi i shtatë nuk është edhe aq i keq", ka thënë Gjakova. Akili humbi një luftë të barabartë pas një gabimi në tentim për ta hedhur në tapetë kundërshtarin duke përfunduar vetë në tapetë. 25-vjeçari i fitoi tri luftërat e para para se të mposhtej në çerekfinale nga xhudisti mongol Tsendochir Tsogtbaatar, ku edhe e humbi

mundësinë për medalje të artë apo të argjendtë. Ai pati mundësi të dytë për medalje, atë të bronzitë, por nuk ia doli ta kalojë gjysmëfinalen e repesazhit, pavarësisht prej luftës së mirë që bëri ndaj azerit. Akili duhet të pajtohet vetëm me vendin e shtatë në Tokio 2020 dhe pa medalje, por ai mund të krenohet me suksesin e motrës së vet, Norës, e cila e ka siguruar të paktën medaljen e argjendtë dhe do të luftojë për medaljen e artë në kategorinë deri në 57 kilogramë. "Si familje jemi tejet të kënaqur dhe si vëlla jam shumë i lumtur", ka shtuar Akil Gjakova.



Shaqirin e tërheq rikthimi në Itali

ROMË, 26 KORRIK - Trajneri i sapoemëruar i ekipit të Lazios u ka kërkuar drejtuesve një sulmues krahu për ta kompletuar organikën e tij. Në pëlqimet e trajnerit toskan është edhe Xherdan Shaqiri. Futbollisti me origjinë

shqiptare, i cili në të kaluarën ka mbrojtur ngjyrat e Interit, është shprehur i nderuar për këtë interesim. Ai ka folur me elozhe për drejtorin sportiv të Lazios, Igli Tare, duke thënë se ka një respekt për të. I pyetur nga mediat italiane për një

rikthim në Itali, 29-vjeçari është përgjigjur: Do të ishte intriguese. "Igli Tare ka bërë një punë të shkëlqyeshme të Lazio. Ndihej i nderuar për interesimin e tyre. E kam ndjekur Lazio për një kohë të gjatë. Është një skuadër e

madhe. Sarri luan me formacionin 4-3-3. U përshtatet karakteristikave të mia dhe më pëlqen trajneri sepse praktikon një futboll sulmues. Do të ishte intriguese një rikthim im në Itali", ka thënë Shaqiri.




Dukagjini transferon ish-futbollistin e Shqipërisë, Ahmed Januzi

Klubi i rikthyer në Superligë, Dukagjini, po vazhdon transferimet bombastike në këtë afat kalimtar. Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Ahmed Januzi, është transferimi i fundit

"Epoka e re"

KLINË, 26 KORRIK - Skuadra e Dukagjinit është duke u përforcuar fuqishëm për edicionin e ri të futbollit 2021/22. Skuadra nga Klina, pas rikthimit në Superligë, ka transferuar disa futbollistë cilësorë, kurse i fundit është Ahmed Januzi, i cili në edicionin e kaluar ishte pjesë e Llapit. Sulmuesi në të kaluarën ka qenë pjesë e Kombëtares së Shqipërisë. Gazeta "Epoka e re" kishte raportuar ditë më parë se skuadra që drejtohet nga trajneri Armend Dallku kishte arritur marrëveshje me ish-sulmuesi kuqezi, por zyrtarizimi ka ardhur të hënën. "Ahmed Januzi, ish-futbollist i Kombëtares së Shqipërisë, tash pjesë e Dukagjinit. Sulmues me përvojë shumë të madhe edhe në Evropë, më saktësisht në futbollin ukrainas, ku për dhjetë vjet ishte aktivizuar te klubi Vorskla në Ukrainë. Me Vorskla,



në mbi 200 paraqitje zyrtare, realizoi 30 gola dhe 18 asistime. Januzi vjen nga skuadra e Llapit. I lindur më 8 korrik 1988, tridhjetë e tre vjeçari karrierën e filloi te klubi i vendlindjes Vushtrria, më pas kaloi në Shqipëri te Besa e Kavajës, nga aty vazhdoi në Superligën e Ukrainës. U rikthye në futbollin e

Kosovës te Prishtina, ndërkohë gjatë sezonit të fundit ishte pjesë e Llapit", thuhet në njoftimin e Dukagjinit. Klubi dukagjinasi më herët ka transferuar edhe Jozef Kuqin, Jean Carioca Da Silva, Moriba Tokpa Lamah, Argjend Bardhin, Ergyn Ahmetin, Henry Chibuzen dhe Arbër Shalën.

Leclerc: Për fitore në Hungari

MONACO, 26 KORRIK - Pas vendit të dytë 10 ditë më parë në pistën e Silverstones, piloti monogask i Ferrarit, Charles Leclerc, mendon me optimizëm për garën e radhës në Hungari (1 gusht). Ai mendon se "kokëkuqja" mund të arrijë një tjetër podium edhe në këtë pistë, andaj me shpresë e sheshtidën e radhës. "Pas garës së fundit është normale të jesh optimist. Mendojmë se mund të dublojmë edhe për fitore në Hungari, jo vetëm për podiumin. Gjithsesi, të jesh forca e tretë pas Red Bullit dhe Mercedesit është një fitore", ka thënë Leclerc. "Pista e Hungarisë nuk është as e shpejtë dhe as e avashtë dhe me një makinë të mirë dhe nëse gomat menaxhohen si duhet,



mund të arrijmë diçka pozitive në Hungari. Gara e Silverstones, me të papriturat e saj, tregoi se

gjithçka mund të ndodhë, ndaj duhet të përfitojmë nga mundësitë", ka shtuar Leclerc.

SHKURT

Eto'o: Messi ka luajtur me mua, jo unë me të

Samuel Eto'o cilësohet një ndër sulmuesit më të mirë në futboll duke shënuar shumë gola dhe fituar shumë trofe në karrierë. Sulmuesi kamerunas kaloi një periudhë të artë te Barcelona ku në pesë vjet arriti ta fitonte edhe Ligën e Kampionëve, madje shënoi edhe në finalen e fituar 3-1 kundër Manchester Unitedit. Padyshim, Eto'o te katalanasit ndau sulmin dhe me Lionel Messin duke formuar një nga sulmet më të rrezikshme në futboll. Në një intervistë Eto'o u ngacmua nga gazetari i cili e pyeti si ishte të luante me Messin, por kamerunasi nuk ngurroi t'i përgjigjej. "Messi ka luajtur me mua, jo unë me Messin. Ai luajti në kohën time, është ndryshe, është totalisht ndryshe", është përgjigjur Eto'o. Pikërisht kjo bisedë ka bërë bujë të madhe në mediat sportive duke u bërë virale.

Varane do t'i bashkohet Unitedit për 50 milionë euro

Manchester Unitedi dhe Real Madridi po negociojnë prej javësh transferimin e Rafael Varane në Premier Ligë. Kontrata e francezit skadon në verën e ardhshme dhe nuk dëshiron të rinovojë, por ka arritur marrëveshje për transferim në United. Edhe klubet, më në fund, kanë arritur marrëveshje. Deportes Cuatro nga Spanja bën me dije se Manchester Unitedi do të paguajë 50 milionë euro për Rafael Varane dhe në orët në vijim të dyja klubet do ta konfirmojnë këtë lëvizje në rrugë zyrtare.

Barcelona 'miqësisht' zgjidh mosmarrëveshjet financiare me Neymarin

Skuadra e Barcelonës njoftoi se ka mbyllur jashtë gjykatës dhe miqësisht disa mosmarrëveshje civile dhe pune që ishin hapur me brazilian Neymar da Silva Santos Junior. "Klubi dhe lojtari kanë nënshkruar kështu një marrëveshje zgjidhjeje të problemeve për t'u dhënë fund procedurave ligjore. Deri më tani ishin pezull midis palëve tri çështje gjyqësore dhe një procedurë civile", thuhet në deklaratën zyrtare nga klubi katalonas mbi mosmarrëveshjet ligjore me Neymarin. Klubi ka mbyllur kështu çështjen në lidhje me një pagesë të pretenduar, të kërkuar nga sulmuesi brazilian, lojtar blaugrana nga viti 2013 deri më 2017, për një bonus nënshkrimi të vendosur në rinovimin e tij të fundit, por asnjëherë të paguar.

Terry largohet nga Aston Villa: Jam gati të bëhem trajner i parë

John Terry largohet nga Aston Villa, një klub ku ishte ndihmëstrajner në stafin e Dean Smith për tri sezonet e fundit. Tani po përgatitet të bëjë një hap përpara në karrierën e tij. Ish-mbrojtësi i Chelseas ka thënë se ishte gati ta drejtonte një ekip personalisht, pasi kjo ka qenë gjithmonë ambicia e tij. "Ka qenë një nder dhe privilegj i jashtëzakonshëm të kaloja dy sezonet e fundit tek Aston Villa, por tani ndiej se është koha e duhur për ta marrë vendimin jashtëzakonisht të vështirë, për të shkuar më tej. Unë dua të jem absolutisht i respektueshëm me menaxhmentin dhe të gjithë tek Aston Villa, por do ta konsideroj seriozisht të ardhmen time këtë verë. Mendoj se nuk është e drejtë të filloj një sezon të ri pa qenë i sigurt për ta përfunduar atë. Për momentin dua të kaloj disa kohë me familjen time, me shpresën për të marrë ftesa për të vizituar klube dhe trajnerë në të gjithë Evropën, për ta kompletuar qëllimin tim: të bëhem trajner", ka thënë Terry.

Juve refuzon Liverpoolin për Chiesan

Federico Chiesa është shndërruar në futbollistin më të kërkuar në merkato pas shkëlqimit të tij në "Euro 2020", ku u shpall kampion me Italinë. Sulmuesi në pronësi të Juventusit u synua pikë së

pari nga Bayerni me një ofertë 80 milionë euro, pasi trajneri i gjermanëve, Julian Nagelsman, doli hapur duke treguar admirimin për Chiesa. Më pas, edhe Chelsea bëri një sulm prej 85

milione paundësh (gati 100 milionë euro), por të dyja ofertat u refuzuan nga ana e "Zonjës së Vjetër". Gjithsesi, sulmet ndaj numrit 22 të bardhezinjve nuk kanë ndërmend të ndalen, ndonëse

edhe dje ka ardhur refuzimi i radhës nga Torino. Skuadra e fundit që bëri ofertë ishte Liverpooli, por sërish 77 milionë paund (rreth 92 milionë euro) nuk mjaftuan për ta joshur Juven.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 28.05.2021 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 27.07.2021 të rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

5 (pesë) Punëtor Fizik -Njësia në Skënderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor,
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi.
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve.
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit,
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve.
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 27.07.2021 deri më datën 10.08.2021. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
 për Kushtet Ndërtimore**

"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 2369/21 të datës 16.06.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
 Ndërtesa e Rilindjes
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
 Suzana.goranci@rks-gov.net
 Telefon: + 381 38 200 32 553



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

**NJOFTIM PËR VAZHDIMIN
 E AFATIT TË KONKURSIT**

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Receptionist/e - KRM "Uniteti"Sh.A Mitrovicë - i Konkursit të shpallur me datë **05.07.2021**

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **27.07.2021**. deri me date **02.08.2021** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M."Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Avdyl Avdyli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Hanemshah Halili nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit " Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose

studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të dispozitave të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitat e Nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë, shpall:

KONKURSET

Për pozitat:

I. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm/Sekretar/e i/e Ndërmarrjes,

Nr. i referencës: 01/3

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Kandidati duhet të ketë diplomë në fushën e Fakultetit Juridik (Jurist i diplomuar ose Master në shkencë Juridike);
- Të posedoj së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes, korporatave ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (l), (j), (k), (l), të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të posedoj njohuri të punës me kompjuter;
- Provimin e Jurisprudencës;
- Njohja e gjuhës angleze.

Detvrat dhe përgjegjësitë

- Shërben si Sekretar i Bordit të Drejtorëve dhe është pikë qendrore e Komunikimit me Komisionin Komunal të Aksionarëve mbi funksionimin e ndërmarrjes NPL "Prishtina Parking" Sh. A.
- Të siguroj përcjelljen e procedurave nga Bordi, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bën përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës.
- Të mbajë procesverbalin e takimeve dhe ti shpërndaj ato tek Drejtorët dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve.
- Të mbajë procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga Kryesuesi i tyre) dhe ti regjistroj ato në librin e protokollit.
- Vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve, të bëjë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit, Komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe Menaxherëve të lartë të ndërmarrjes.
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të ndërmarrjes duhet të jenë në dispozicion të të gjithë Drejtorëve të Bordit dhe duhet të siguroj që ato përputhen me procedurat e Bordit.
- Mirëmban regjistrat e të dhënave të ndërmarrjes.
- Përcjell ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes për ndryshimet si dhe përgatit udhëzime të nevojshme për Menaxhmentin të ndërmarrjes.
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet për ligjin për ndërmarrjet publike ose nga statuti i ndërmarrjes.
- Koordinon me KE-në përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- Merret me çështje tjera të qeverisjes së ndërmarrjes sipas nevojës.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Këshilltar/e i/e Përgjithshëm/Sekretar/e i/e Ndërmarrjes duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Juridik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

II. Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e (ZKF) dhe i Thesarit,

Nr. i referencës: 03

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi Universitar Fakulteti Ekonomik nga Fusha e Financave/kontabilitetit (Ekonomist i diplomuar ose Master në shkencat ekonomike);
- I Certifikuar me diplomë profesionale SCAAK apo ACCA apo të ngjashme;
- Të posedoj përvojë profesionale mbi pesë (5) vite nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Njohja e gjuhës angleze.

Detvrat dhe përgjegjësitë

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;

- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësi;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitetet si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregullore të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve;
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKFTH i raporton KE-së si dhe Bordit të Drejtorëve;
- Kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE dhe Bordi i Drejtorëve.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e (ZKF) dhe i Thesarit duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Ekonomik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

III. Zyrtar/e për Auditim

Nr. i referencës: 01/2

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi Universitar Fakulteti Ekonomik nga Fusha e Financave/kontabilitetit (Ekonomist i diplomuar ose Master në shkencat ekonomike);
- Përvoja e punës mbi pesë (5) vite në pozita menaxhuese të auditimit pas diplomimit;
- Të jetë i licencuar për auditor (SCAAK, ACCA) apo të ngjashme;
- Njohja e gjuhës angleze;
- Njohja e mire e punë me kompjuter (MC Office).

Detvrat dhe përgjegjësitë

- Rregullisht shqyrton gjendjen financiare të ndërmarrjes, kërkesat e planifikuara financiare dhe përmes vërejtjeve apo sugjerimeve njofton Komisionin e Auditimit kur e konsideron të nevojshme.
- Rregullisht e verifikon funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme dhe nëse e konsideron të nevojshme njofton Komisionin e Auditimit përmes vërejtjeve apo sugjerimeve me shkrim.
- Rregullisht verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të punës të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i ndërmarrjes duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahen në pajtim me standardet e kontabilitetit dhe ligjet në fuqi. Kujdes të veçantë ushtron që projekt – deklaratat financiare vjetore të përgatit në mënyrë të rregullt dhe lidhur me këtë ti raportoj Komisionit të Auditimit kur e konsideron të nevojshëm.
- Verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat garantojnë se ndërmarrja zbaton standardet dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Kryen vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve përmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe informative të ndërmarrjes.
- Përcakton llojin dhe tekniken e auditimit të brendshme për secilin rast konkret duke u bazuar në ligjet pozitive, aktet normative praktiken e mire dhe njohurit profesionale.
- Koordinon mënyrën e bashkëpunimit me auditorët e jashtëm dhe kujdeset që palët të jenë në dijeni, siguron dokumentacionin e nevojshëm dhe raporton për fushat gjegjëse, financiare dhe të prokurimit por duke pasur për bazë konfidencialitetin.
- Propozon masat që duhet të ndërmirë nga ndërmarrja për ngritjen e efikasitetit dhe zbatimit të rregullave gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Zbaton të gjitha rregullat dhe standardet të cilat kanë të bëjnë me auditimin e brendshme duke i raportuar KE-së, Komisionit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve.
- Duhet të demonstroj integritet personal dhe profesional duke bashkëpunuar me menaxhmentin, Komisionin e Auditimit dhe KE-në.
- Kryen edhe punë të tjera për të cilat kërkohet nga menaxhmenti dhe Komisioni i Auditimit.

Kohëzgjatja e punësimit, të drejtat dhe obligimet përcaktohen me kontratë punësimi në kohe të caktuar për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Zyrtar/e për Auditim duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e Aplikantit;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Ekonomik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës (Trusti pensional);
- Certifikatë për auditor të licencuar;
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e Lejes së Njoftimit.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Zyrën Qendrore të NPL "Prishtina Parking" Sh. A., rr. "Luan Haradinaj", p.n., Pallati i Rinisë dhe Sporteve (ish objekti i ASK), 10000, Prishtinë, Kosovë.** Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data: 26 Korrik 2021 – 09 Gusht 2021 ora 16:00.**

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi


Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë









www.facebook.com/gjejpuneshpejte





Lume's Details


Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Avdyl Avdyli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Hanemshah Halili nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

